



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.118, datë 29.05.2023

PËR

**“RENDITJEN E KANDIDATËVE PËR POZICIONIN VAKANT NR.3 NË
PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË, SHPALLUR ME VENDIMIN
NR.67, DATË 21.03.2023 TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË”**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 90, pika 2 të “Kodit të Procedurave Administrative”, nenin 43 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 43 dhe 44 të Rregullores “Për transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele” të ndryshuar, si dhe relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve për pozicionin vakant Nr.3, shpallur me vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nr.67, datë 21.03.2023, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë si më poshtë:
 1. Alma Felaj
 2. Afrim Shehu
 3. Arbër Berexha
 4. Andi Pogaçe
 5. Ilir Hoxha
 6. Neritan Hoxha
2. Mos vazhdimin e procedurës së transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele, për kandidatët Alma Bramo, Urim Buci, Alba Dhima, Erida Visoci, Ermira Manelli, Françesk Ganaj dhe Xhoana Mehmetaj.
3. Të përfundojë procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele, për kandidaten Vitjuna Mata.
4. Relacioni i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
5. Të njoftojë të gjithë kandidatët për këtë Vendim.

6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e njoftimit të këtij vendimi.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare ëeb të Këshillit.
8. U shpall në Tiranë, sot më 29.05.2023.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR
Alfred Balla

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Bujar Sheshi

ANËTAR
Nurihan Sciti

ANËTAR
Elaida Goxhi

ANËTAR
Esmeralda Keshi

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Ledina Riza

